

Të kuptuarit e Qeverisë:
**Përmirësimi i Transparencës dhe
Llogaridhënies Institucionale përmes të
Dhënave të Hapura**



| *Doracak*



Përmbajtja

Çka janë të Dhënat e Hapura ?.....	1
Të Dhënat e Hapura Ndërkombëtarisht.....	3
Të Dhënat e Hapura në Kosovë.....	4
Standardet e të Dhënave të Hapura.....	6
Licensimi i të Dhënave të Hapura.....	7
Të Dhënat e Hapura me 5 yje.....	9
Parimet e të Dhënave të Hapura.....	13
Open Data Kosovo - Kush jemi ne?.....	17
Infografikë e të Dhënave të Hapura.....	19

Çka janë të Dhënat e Hapura?

Jemi duke jetuar në kohën e informacionit. Sipas IBM-së, ne krijojmë 2,500,000 terabyte të dhëna çdo ditë - aq shumë sa 90% i të dhënave në botë janë krijuar vetëm në dy vitet e fundit. Edhe qeveritë sikurse individët dhe organizatat private prodhojnë sasi të pakufizuara të dhënave si pjesë e punës së tyre të përditshme - të dhëna mjedisore, të dhënat e pasagjerëve të transportit publik, shifrat e frekuentimit në spital, rezultatet e provimeve të shkollave etj. Këto të dhëna përdoren nga qeveritë për t'i përmirësuar shërbimet publike, dhe për t'i zhvilluar dhe zbatuar politikat. Megjithatë, në sektorin publik, të dhënat e publikuara zakonisht janë informacione dytësore: studime, raporte etj. Edhe pse këto informacione mund të bëhen të hapura ato nuk konsiderohen si të dhëna të hapura. Të Dhënat e Hapura i referohen të dhënave të papërpunuara, të dhëna numerike apo statistike si p.sh. matjet e temperaturës, viti i ndërtimit të një shkolle, mënyrat e transportit në dispozicion në një qytet etj. Pra, ideja e të Dhënave të Hapura është publikimi i të dhënave të papërpunuara, pasi që kjo lehtëson ripërdorimin e të dhënave për qëllime të reja, duke sjellë përfitime shoqërore dhe ekonomike.

Fondacioni i Njohurive të Hapura (The Open Knowledge Foundation) i definojnë të Dhënat e Hapura si: Të hapura nëse çdokush është i lirë t'i përdor, ripërdor, dhe t'i rishpërndajë ato - me kushtin e vetëm që të citohet burimi. Të Dhënat e Hapura duhet të jenë të përdorueshme jo-komercialisht dhe komercialisht.

Qëllimet kryesore të publikimit të të dhënave janë:

- *Që të dhënat të jenë të dobishme, kuptimplotë dhe të qasshme.*
- *Që të dhënat e publikuara të sjellin vlerë, të sigurojnë dialog dhe diskutim të vazhdueshëm për çdo ekonomi.*
- *Që të dhënat të jenë transparente dhe llogaridhënëse për të ndihmuar rritjen e besimit në mes të qeverisë dhe popullit.*
- *Që të rritet pjesëmarrja e qytetarëve në diskutime përmes të dhënave dhe përdorimit të tyre p.sh. përmes aplikacioneve.*
- *Që aktivitetet, politikat dhe masat e institucioneve publike të jenë më transparente dhe ti nënshtrohen shqyrtimit më të madh nga qytetarët, shoqëria civile dhe mediat.*
- *Që të dhënat të analizohen dhe të ripërdoren nga hulumtuesit, zhvilluesit dhe sipërmarrësit në mënyra inovative*

Të Dhënat e Hapura Ndërkombëtarisht

Elemente të të Dhënave të Hapura mund të vërehen në shumë iniciativa dhe lëvizje të më hershme, siç janë:

- *Liria e Informacionit*
- *Iniciativat për Transparencë dhe Pjesëmarrje*
- *Iniciativat e Shkëmbimit të të Dhënave*
- *Ripërdorimi i Informacionit të Sektorit Publik*
- *Qasja e Hapur*
- *Burimi i Hapur*
- *Qeveria e Hapur*

Koncepti i të Dhënave të Hapura, në aspektin që përdoret në ditët e sotme, u shfaq rreth vitit 2007, ku aktivitetet e para filluan në SH.B.A dhe MB.

Në vitet e fundit, qeveria lokale, regjionale dhe shtetërore kanë zhvilluar strategji të të Dhënave të Hapura, ku kanë hapur portale dhe kanë publikuar të dhënat duke u bazuar në Licencat e Hapura. Poashtu shumë organizata jo-qeveritare vazhdojnë të publikojnë të Dhëna të Hapura, si p.sh. Banka Botërore dhe Kombet e Bashkuara. Kohët e fundit, publikimin e të Dhënave të Hapura e kanë filluar edhe disa subjekte komerciale. Ekziston një numër i madh i organizatave ndërkombtare të cilat merren me hulumtimin, përdorimin dhe teknologjinë e të Dhënave të Hapura.

Disa nga ato janë: *Komisioni Evropian, Banka Botërore, Partneriteti për Qeverisje të Hapur, Instituti i të Dhënave të Hapura, Fondacioni i Njohurive të Hapura, Konsorciumi i World Wide Web, Qendra Depërtuese për Analiza të të Dhënave, Rrjeti i Hulumentit të të Dhënave, Govlab dhe Fondacioni Sunlight.*

Të Dhënat e Hapura në Kosovë

Inventari i të Dhënave të Hapura (Open Data Inventory) bën vlerësimin e nivelit të hapjes së statistikave për të ndihmuar në identifikimin e problemeve, promovon politikat e të dhënave të hapura, përmirëson qasjen, dhe inkurajon dialog në mes të organizatave kombtare të statistikave (NSOs) dhe përdoruesve të të dhënave. Inventari i të Dhënave të Hapura përfshin 180 shtete, ku shumica e shteteve janë anëtar të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD). Kosova zë vendin e 68-të në vlerësimet e Inventarit të të Dhënave të Hapura në vitin 2017, një ndryshim pozitiv nëse e krahasojmë me vlerësimet e vitit 2016 ku Kosova renditej në vendin e 82-të.

Rrjedhimisht, u përmirësua edhe rezultati ODIN i Kosoves, i cili nga 39 pikë u ngrit në 44 pikë. Në Evropën Juglindore, Shqipëria u rendit në vendin e 40-të dhe Maqedonia u rendit në vendin e 32-të. Shtetet tjera, si Serbia dhe Bosnja u renditën në vendet 94 dhe 109.

Organizata joqeveritare, Open Data Kosovo, që nga themelimi i saj në vitin 2014 mundëson hapjen e të dhënave në qeveri. Shumica e të Dhënave të Hapura të publikuara në Kosovë u mundësuan nën mbikqyrjen dhe ekspertizën e ODK-së, duke përfshirë prokurimin, cilësinë e ajrit, cilësinë e ujit, monitorimin e zgjedhjeve, deklarimin e pasurive etj. ODK përkrahë dhe lobon në miratimin e praktikave më të mira të transparencës digjitale në qeveri si p.sh. krijimin dhe zhvillimin e një portali kombtarë të të dhënave; Portali i të Dhënave të Hapura (Government Open Data Portal) dhe përdorimin e licencimit të hapur për të dhëna dhe kodi burimor i softuerit.

Portali i të Dhënave të Hapura u zhvillua për të shërbyer si mjet për rritjen e transparencës në mes të zyrëtarëve qeveritar, me anë të publikimit të dataseve-ve. Institucionalizimi i përdorimit të portalit ishte një faktor i rëndësishëm për suksesin e këtij projekti. Gjithashtu në kuadër të projektit u hartua dhe u zbatua një program trajnim gjithëpërfshirës me synim zyrtarët e qeveritar.

Një shembull tjetër i hapjes së të dhënave në Kosovë është Gjakova Portal. Përmes këtij portali komuna e Gjakovës është më afër qytetarëve të saj ku me anë të informatave të nevojshme paraqitet e kaluara dhe gjendja e tanishme e komunës. Gjakova Portal mundëson promovimin e komunës së Gjakovës në fushën e investimit, turizmit dhe rekreacionit, kështu duke ofruar informacione në një mënyrë më të qasshme mbi sfera të ndryshme të jetës në këtë komunë, brenda dhe jashtë territorit të Kosovës.

Standardet e të Dhënave të Hapura

Standardet e të dhënave ndihmojnë t'i jepin kuptim të dhënave. Kjo është e rëndësishme sidomos kur të dhënat publikohen brenda departamenteve, organizatave apo edhe kufinjëve ndërkombëtarë, pasi që përdoruesi i të dhënave mund të interpreton të dhënat me kuptimin e tyre të vërtetë. Standardet e të dhënave nuk e përcaktojnë vetëm kuptimin e koncepteve të caktuara, por edhe mënyrën se si ndërliohen konceptet me njëra tjetrën. Këto Standarde duhet të jenë edhe në formate të lexueshme nga njerëzit edhe në formate që procesohen lehtë nga kompjuteri.

Standardet e të dhënave mundësojnë shkëmbimin e të dhënave brenda një komuniteti - komunitetit të adoptuesve dhe zbatuesve. Këto komunitete ndryshojnë nga madhësitë e tyre. Disa standarde, si p.sh. ISO standardet, janë komunitet global. Shumica e standardeve drejtohen nga komunitete të specialistëve që janë të interesuar në shkëmbimin e të dhënave specifike. Si p.sh. ekzistojnë standarde për të dhëna gjeohapësinore (zhvilluar nga përdoruesit e programit të sistemit informativ GIS), për të dhëna statistikore (të zhvilluara nga zyret e statistikave dhe prodhuesit e tjerë të statistikave), të dhëna financiare etj.

Licencimi i të Dhënave të Hapura

Ajo që i bën të Dhënat e Hapura të 'hapura' është liria e përdorimit të tyre, përfshirë edhe për përdorim komercial. Lidhja e Licencimit së Hapur me të Dhënat e Hapura është e nevojshme për të siguruar bazueshmërinë ligjore për ripërdorimin e mundshëm të tyre. Kur përdoruesit e të dhënave (individë/organizatë/kompani etj.) dëshirojnë të përdorin dhe të ndërtojnë në krye të të dhënave publike, ata fillimisht duhet të sigurohen që ligjërisht mund ose nuk mund ti përdorin të dhënat. Nëse nuk specifikohet asnjë licencë, çdo përdorues i të dhënave duhet të kontaktojë publikuesin e tyre në secilin rast të përdorimit. Një Licencë e hapur i lejon publikuesit të përcaktojë termat nën të cilat mund të përdoren të dhënat. Termat kryesore që janë specifikuar në Licencat e Hapura janë atribuimi (*attribution*) dhe ndarja (*share-alike*). Në përgjithësi, atribuimi (*attribution*) do të thotë që përdoruesi i të dhënave duhet të kreditojë publikuesin e të dhënave për krijimin origjinal, kurse ndarja (*share-alike*) do të thotë që përdoruesi i të dhënave duhet të licencojë krijimet e reja nën kushte identike si të dhënat origjinale. Atribuimi mund të ndihmojë në rritjen e transparencës së iniciativave të të dhënave të hapura.

Përveç publikimit të të dhënave edhe *metadata-t* duhet të publikohen nën Licencë të Hapur. Kjo siguron që të dhënat janë të hapura dhe rritë potencialin e përdorimit të tyre, pasi që njerëzit mund të lexojnë lirshëm përshkrimet e të dhënave. Metadata duhet të botohet gjithmonë nën një Licencë të Hapur, edhe nëse të dhënat bazë nuk janë (*Metadata do të thotë informacion i strukturuar në lidhje me një burim, për shembull, metadataat rreth një dataset-i të dhënash përfshin titullin, përshkrimin, temën, datën e krijimit, mbulimin kohor etj*).

Të gjitha licencat e përdorura zakonisht për të Dhënat e Hapura deklarojnë se të dhënat ofrohen ashtu si janë. Publikuesi nuk garanton saktësinë, afatet kohore, ofrimin e tij në një format të caktuar, ose disponueshmërinë e tij në të ardhmen. Çdo gjë është subjekt i ndryshimeve ose korigjimeve në të ardhmen.

Praktika më e mirë për të publikuar të Dhënat e Hapura është pa pagesë, mirëpo ndonjëherë mund të duhet të bëhet pagesë për SLA nëse ata kërkojnë që publikuesi i të dhënave të ofrojë shërbime shtesë të të dhënave dhe / ose infrastrukturë në krye të të dhënave origjinale.

Të Dhënat e Hapura me 5 ★

Në vitin 2010, themeluesi i World Wide Web dhe krijuesi i Web Semantik dhe Linked Data, Sir Tim Berners-Lee, sugjeron një skemë me 5 yje për të vlerësuar të Dhënat e Hapura. Ideja prapa këtij formati është; që sa më i madh numri i yjeve, aq më të përdorshme dhe lehtë të ripërdorshme janë të dhënat. Vlerësimi fillon me një yll pastaj yjet tjera shtohen varësisht nga formati i përdorur dhe linqet që vendosen. Më poshtë janë përshkrimet se çfarë përfaqëson secili yll:

Të Dhëna me një-yll ★

Si PËRDORUES

- Mund t'i shikoni
- Mund t'i printoni
- Mund t'a ruani (në hard drive apo në USB)
- Mund t'i futni të dhënat në një sistem tjetër
- Mund t'i ndryshoni të dhënat sipas dëshirës
- Mund t'i ndani të dhënat me personat që dëshironi

Si PUBLIKUES

- Janë të lehta për t'u publikuar
- Nuk ka nevojë të sqaroni në mënyrë të përsëritshme të tjerëve që ata mund t'i përdorin të dhënat e juaja

Të Dhëna me dy-yje ★★

Si PËRDORUES

Mund t'i bëni gjërat e njejta si te ato me një yll dhe gjithashtu :

- Mund t'i përdorni ato me softuerin e patentuar për t'i kalkuluar, grumbulluar, vizualizuar etj
- Mund t'a ndryshoni në një format (të strukturuar) tjetërt

Si PUBLIKUES

- Janë të lehta për t'u publikuar

Të Dhëna me tre-yje ★★★

Si PËRDORUES

Mund t'i bëni gjërat e njejta si te ato me dy yje dhe gjithashtu:

- Mund t'i ndryshoni të dhënat në çdo mënyrë që dëshironi, pa pasur nevojë të keni paketën e softuerit të patentuar

Si PUBLIKUES

Mund të keni nevojë për konvertues apo shtojca për t'i eksportuar të dhënat nga formati i patentuar

- Janë ende mjaft të thjeshta për t'u publikuar

Të Dhëna me katër-yje ★ ★ ★ ★

Si PËRDORUES

Mund t'i bëni gjërat e njejtë si të ato me tri yje dhe gjithashtu:

- Mund të lidheni me të nga çdo vend tjetër (në Web ose në nivel lokal)
- Mund t'a nënvizoni
- Mund t'i ripërdorni disa pjesë të të dhënave
- Ju do të mund të ripërdorni veglat ekzistuese dhe bibliotekat, edhe nëse ata i kuptojnë vetëm pjesët e modelit që ka përdorur botuesi
- Kuptimi i strukturës së një RDF "Grafiku" të të dhënave mund të jetë më e vështirë sesa të dhënat tabelare (Excel / CSV) ose tree (XML / JSON)
- Ju mund të kombinoni të dhënat me të dhëna të tjera në mënyrë të sigurtë. URI-të janë skema globale ku nëse dy gjëra kanë të njëjtin URI do të thotë që kjo është e qëllimshme, dhe nëse është kështu, atëherë kjo është mënyra e drejtë për të qenë të dhëna me 5 yje!

Si PUBLIKUES

- Mund të keni kontroll mbi artikujt e të dhënave dhe mund të zgjedhni aksesin e tyre (balancimin e ngarkesës, caching, etj)
- Publikuesit e tjerë të të dhënave mund të lidhen në të dhënat e juaja, duke e promovuar në 5 yje!
- Zakonisht investoni një pjesë të kohës në presje dhe rregullim të të dhënave
- Do të duhet të caktoni URI tek artikujt e të dhënave dhe të mendoni se si t'i përfaqësoni të dhënat
- Do të j'u duhet të gjeni modele ekzistuese për t'i ripërdorur apo ti krijoni të juajat

Të Dhëna me Pesë-yje ★ ★ ★ ★ ★


Si PËRDORUES

Mund t'i bëni gjërat e njëjta si te ato me katër yje dhe gjithashtu:

- Mund të gjeni më shumë të dhëna (të lidhura) gjatë përdorimit të të dhënave
- Mund të mësoni drejtpërdrejt në lidhje me skemën e të dhënave
- Presentimi i të dhënave nga një lidhje arbitrare si fakt është po aq e rrezikshme sa të lejosh njerëzit të përfshijnë përmbajtje nga ndonjë faqe në faqet tuaja. Kujdes, besimi dhe ndjenja e shëndoshë janë ende të nevojshme

Si PUBLIKUES

- I bëni të dhënat tuaja të qasshme
- E rritni vlerën e të dhënave tuaja
- Organizata juaj do t'i ketë të njëjtat përfitime nga lidhjet sikurse përdoruesit
- Do të duhet të investoni burime për t'i lidhur të dhënat tuaja me të dhëna të tjera në web
- Do të duhet të siguronit burime për lidhjen e të dhënave tuaja me të dhënat tjera në web
- Mund të keni nevojë të rregullo- ni lidhjet e prishura apo të pasak- ta



Parimet e të Dhënave të Hapura

Publikimi i të dhënave kërkon përgjegjësi dhe kujdes të duhur. Kur bëhet publikimi i të dhënave, duhet siguruar që ato janë në kualitetin e duhur në mënyrë që të jenë sa më të qasshme, lexueshme dhe të përdorueshme.

Parimi 1

Parimi: Të Dhënat e Hapura duhet të respektojnë privatësinë e individit.

Praktika: Sigurohuni që të dhënat të mos jenë informacione që identifikojnë individin siç përshkruhet në ICO code of practice.

Parimi 2

Parimi: Të dhënat duhet të jenë gjithëpërfshirëse.

Praktika: Sigurohuni që cilësia e të dhënave të jetë në nivelin e duhur para se të publikohen ato. Mos i publikoni të dhënat që nuk janë të përfunduara, në mënyrë të qëllimshme për një periudhë të caktuar kohore.

Parimi 3

Parimi: Të dhënat e hapura duhet të jenë relevante dhe të lidhura mirë me subjektin.

Praktika: Gjithmonë konsideroni shtrirjen dhe përhapjen e të dhënave - për ta bërë të dobishme për ata që mund të dëshirojnë të kenë qasje në të.

Parimi 4

Parimi: Të dhënat duhet të jenë në madhësi të përdorueshme në kompjuter personal.

Praktika: Gjithmonë keni parasyshë madhësinë e të dhënave, në mënyrë që ato të jenë të qasshme nga çdokush që dëshiron të ketë qasje në to.

Parimi 5

Parimi: Të dhënat e hapura duhet të përdorin referencat e zakonshme në dispozicion kur është e mundur.

Praktika: Gjithmonë jepni kodet dhe kërkimet për të dhënat tona, veçanërisht në aspektin e gjeografisë administrative. Ne do të publikojmë të dhëna që janë të lira nga zhargoni, akronimet e dokumenteve dhe shkurtesat e përdorura.

Parimi 6

Parimi: Të dhënat duhet të prezentohen në një format teknike të përbashkët.

Praktika: Të dhënat duhet të publikohen në formate të qasshme dhe standarde siç janë: CSV, JSON dhe XML. Mos i publikoni të dhënat në formate të komplikuara, të zgjatura dhe të patentuara.

Parimi 7

Parimi: Të Dhënat e Hapura duhet të jenë të licencuara në mënyrën e duhur.

Praktika: Gjithmonë bashkangjiteni licencën në datase të hapura.

Parimi 8

Parimi: Të Dhënat e Hapura duhet të jenë të dokumentuara në mënyrën e duhur.

Praktika: Gjithmonë bashkangjitni shënimet dhe udhëzimet në data-sete. Tregoni detajisht natyrën, fushën dhe qëllimin e dataseteve të hapura në një dokument të publikuar, të qasshme për të gjithë. Mos i publikoni të dhënat në mënyrë të qëllimshme me përshkrime të dobëta, apo që kërkojnë njohuri të fushave të caktuara për t'u kuptuar.

Parimi 9

Parimi: Të dhënat duhet të jenë të qasshme dhe të qëndrueshme.

Praktika: Gjithmonë publikoni të dhënat në mënyrë të vazhdueshme, duke i bërë të qasshme për të gjithë. Mos publikoni të dhëna që kanë nevojë për fjalëkalime apo që kanë qasje të kufizuar, përveq rasteve të nevojshme.

Parimi 10

Parimi: Të Dhënat e Hapura duhet të jenë të përditësuara.

Praktika: Gjithmonë sigurohuni që të bëni përditësime në data-sete në mënyrë të rregullt dhe në kohë.

Parimi 11

Parimi: Pranoni komente dhe diskutime rreth të dhënave të hapura.

Praktika: Gjithmonë sigurohuni të kjo të bëni mënyrën se si të bëhen komente për të Dhënat e Hapura në dokumentet publike. Mos i publikoni të dhënat pa mekanizëm për komente.

Parimi 12

Parimi: Përdorini të Dhënat e Hapura tuaja.

Praktika: Përdorni grupet e të dhënave vetanake në kanalet e brendshme dhe të jashtme - duke ofruar komentime, analiza dhe njohuri.

Parimi 13

Parimi: Përdorni të dhëna të tjera të rëndësishme.

Praktika: Përdorni datasete të tjera që janë në dispozicion. Gjithmonë jepni udhëzime të kjarta për burimet e të dhënave apo veprimet që keni ndërmarrë.

Parimi 14

Parimi: Largoni të dhënat e pasakta.

Praktika: Largoni apo zëvendësoni me kohë dhe me kujdes, të Dhënat e Hapura të publikuara në të cilat janë identifikuar gabime.

Open Data Kosovo

Kush jemi ne?

ODK dizajnon, zhvillon dhe krijon zgjidhje dixhitale për një portfolio të gjerë të klientëve, ndër të cilët janë edhe institucionet publike të Kosovës. Ekspertiza e organizatës në mbledhjen dhe analizimin e të dhënave, bën pajisjen e klientëve dhe partnerëve me mjete dhe njohuri që mbështesin vendim-marrjen, politikë-bërjen me të dhëna në strategji ditore. ODK përkrahë barazinë gjinore, duke përqendruar aktivitetet e organizatës në angazhimin e të rinjve në drejtim të fuqizimit të grave të reja të interesuara në teknologji dhe duke bashkëpunuar me organizatat relevante si Girls Coding Kosova. Të gjitha projektet vendore, ndërmarrë nga ODK përfshijnë rritjen transparencës në proceset qeverisëse, duke hapur të dhënat e qeverisë dhe duke hedhur dritë mbi punën e brendshme të aktiviteteve qeveritare (p.sh. hapja e të dhënave të prokurimit për të dokumentuar dhe monitoruar më mirë praktikën e prokurimit). Jashtë Kosovës, ODK udhëheqë dhe bashkëpunon në iniciativë të ndryshme të cilat promovojnë praktikën më të mirë të të dhënave të hapura, ndër të cilat Open Contracting Data Standards. ODK poashtu ka marrë mirënjohje ndërkombëtare për zhvillimin e një algoritmi red-flag i cili në mënyrë automatike analizon të dhënat e hapura të prokurimit në Kosovë dhe thekson parregullsitë e mundshme në përdorimin e parave publike.

Në përfitimin nga hapja e të dhënave, në Ballkanin Perëndimor dhe mbarë botën, ODK ka kontribuar në konferencën e Institutit Aspen "Roli i Digjitalizimit për Zhvillimin Ekonomik të Rajonit të Ballkanit Perëndimor" ("The Role of Digitalization for the Economic Development of the eastern Balkan Region"), me anë të një punimi shkencor dhe prezantimi mbi "Angazhimin e Qytetarëve të Kosovës në Iniciativa Civic-Tech për Rritjen e Transparencës së Qeverisë dhe Punësimin e të Rinjëve me anë të të Dhënave" ("Citizen Engagement in Kosovo with Open Data Driven Civic-Tech Initiatives for Increased Government Transparency and Youth Employability."). Në kuadër të projektit TransparenCEE, një rrjet i organizatave jo-qeveritare në Evropën Lindore Qendrore dhe Euroaziatike të interesuar për rritjen e transparencës dhe llogaridhënies nga përdorimi i teknologjisë, ODK ka kryer hulumtime të gjera për hapjen e të gjitha institucioneve publike në Kosovë (përfshirë mijëra indikator) dhe hartimin e raporteve të politikave që mbulojnë të gjithë spektrin institucional. Ky projekt ka kontribuar në krijimin e një indeksi rajonal të transparencës së qeverisë e cila mundëson analiza krahasuese ndër-vendore.


ODK poashtu ka qenë e përfshirë në krijimin e produkteve digjitale me shërbime zhvilluese për OJQ të cilat operojnë në fushat që kanë të bëjnë me ndërhyrjet sociale dhe humanitare. Në këtë fushë, ODK u dekorua me çmimin Albanian ICT Award 2017 recognition for Decode Darfur, një projekt (aplikim) që mundëson identifikimin e zonave të prekura nga dhuna dhe shkatërrimet në Sudan përmes përdorimit të imazheve satelitore.




DATA NEVER SLEEPS 5.0

How much data is generated *every minute*?

90% of all data today was created in the last two years—that's 2.5 quintillion bytes of data per day. In our 5th edition of Data Never Sleeps, we bring you the latest stats on just how much data is being created in the digital sphere—and the numbers are staggering.



The world internet population has grown 7.5% from 2016 and now represents 3.7 billion people.



GLOBAL INTERNET POPULATION GROWTH 2012-2017 (IN BILLIONS)

With each click, swipe, share, and like, businesses are using data to make decisions about the future. Domo gives everyone in your business real-time access to data from virtually any data source in a single platform for smarter decision-making at any moment.

Learn more at domo.com

SOURCES: EXPANDED DRAMBLINGS.COM, WEARESOCIAL.COM, WIKIPEDIA, FORBES, ADWEEK.COM, FORTUNE.COM, BLOOMBERG.COM, ONEREA.CH/COM, IBM, BUZZFEED, INTERNET LIVE STATS, INTERNET WORLD STATS, BBC



Referencat

5 star Open Data, 2015

www.5stardata.info/en

Domo, Inc. 2018

www.domo.com/learn/data-never-sleeps-5

Gjakova Portal, 2018

www.gjakovaportal.com/en/About-Us

Ontotext, 2018

www.ontotext.com/knowledgehub/fundamentals/five-star-linked-open-data

Open Data Kosovo, Retrieved 2018

www.opendatakosovo.org

Open Data Inventory, 2018

www.odin.opendatawatch.com

Open Data Ireland, "Best Practice Handbook", 2014

www.per.gov.ie/wp-content/uploads/Best-Practice-Handbook.pdf

Open Government Data Portal, 2016

www.opendata.rks-gov.net

Open Data Services Co-operative Limited, 2015

www.opendataservices.coop



B | T | D The Balkan Trust
for Democracy
A PROJECT OF THE GERMAN MARSHALL FUND

G | M | F The German Marshall Fund
of the United States
STRENGTHENING TRANSATLANTIC COOPERATION